


Wir  
machen  
das. **ST.GALLEN**  
**IMPFT!**

Kanton St.Gallen  
Gesundheitsdepartement




**VAKSINIMI**  
**KUNDËR COVID-IT**  
**REGJISTROHUNI TANI**  
[www.wir-impfen.ch](http://www.wir-impfen.ch)

Në Kantonin St.Gallen, të gjithë të rriturit mund të regjistrohen për një vaksinim falas kundër koronës.



## REGJISTRIMI NË QENDRËN E VAKSINIMIT

Kështu regjistroheshi në qendrën e vaksinimit për një termin vaksinimi. Nëse nuk keni internet, adresë e-mail-i ose nëse keni vështirësi me gjuhën, kërkoni ndihmën e personave të tjerë (familjarë, miq ose persona të njohshëm).



1. Vizitoni faqen e internetit [www.wir-impfen.ch](http://www.wir-impfen.ch)
2. Klikoni «Zur Registrierung»
3. Regjistrohuni: shënoni emrin dhe mbiemrin, adresën e e-mail-i dhe fjalën e kalimit, në vijim klikoni në «Registrieren».
4. Ju merrni një e-mail, në të cilin ju duhet ta konfirmoni regjistrimin tuaj.
5. Pas regjistrimit, ju mund të lajmëroheni për një termin vaksinimi. Zgjidhni qendrën e dëshiruar të vaksinimit (St.Gallen, Wil, Rapperswil-Jona ose Buchs) dhe plotësoni formularin e lajmërimit.
6. Me e-mail ju merrni një konfirmim lajmërimi dhe tashme ju jeni regjistruar për një vaksinim kundër Covid-19. Ju e merrni terminin e vaksinimit me e-mail. Ju mund të zgjidhni një termin tjetër, nëse termini i parë nuk ju përshtatet.

## REGJISTRIMI TE MJEKU I FAMILJES

Ju gjithashtu mund të lajmëroheni te mjeku juaj i familjes.

Këta persona vaksinohen vetëm nga mjeku i familjes:

- persona me alergji të rënda kundër medikamenteve ose lëndëve të vaksinimit
- persona me sëmundje kronike
- persona, që dëshirojnë një konsultim vaksinimi
- gra shtatzëna

## INFORMATA TË TJERA

Ju tashme keni qenë të prekur nga korona? Atëherë për të paktën 6 muaj ju jeni të mbrojtur dhe mund të prisni 6 muaj derisa të vaksinoheni.

## A KENI PYETJE PËR VAKSINIMIN?

shërbimi telefonik / numri i telefonit: 058 229 22 33  
[support@wir-impfen.ch](mailto:support@wir-impfen.ch)

